

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi i Hagës, Vuçiç 'sulmon' reagimet e Presidentit Begaj e Ramës: Imagjinoni sikur një zyrtar i yni të thoshte 'Liria ka emër'
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/vendimi-i-hages-vucic-on-reagimet-e-presidentit-begaj-e-rames-imagjin-i586562
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 19:38:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 19:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f307607e365115e93c9a91174794173fbe3eeffad4789d6420355995f1e31fd0
TEKSTI	d4f6096c92bef18eaa7a6bd094d32986cc7d22e4cb991c2a735390d44f5798f0
PAMJA	7b841c1190d4a8805ea7a4b51a6e941a65480c640c8dfed6dad2f48692af5a65

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0b91197a70e45e6a835ee85b7a9ee982e7432c587927b3b8b8643fcf2b57a531
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a2ff65fb1ec0abbd824a4690f8572392275823afe6c37713ebc7a42874eb87f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0b91197a70e45e6a835ee85b7a9ee982e7432c587927b3b8b8643fcf2b57a531>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Vendimi i Hagës, Vuçiç 'sulmon' reagimet e Presidentit Begaj e Ramës: Imagjinoni sikur një zyrtar i yni të thoshte 'Liria ka emër' Kritten tensionet 'Turqi-Greqi, Ankaraja zi fundit

Vendimi i Hagës, Vuçiç 'sulmon' reagimet e Presidentit Begaj e Ramës: Imagjinoni sikur një zyrtar i yni të thoshte 'Liria ka emër'



16 Shtator 2026, 21:30Rajoni TEMA



Presidenti serb Aleksandër Vuçiç reagoi ditën e sotme, pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, që dënuan me 81 vite burg në total 4 ish-krerët e UÇK-së.

Vuçiç tha se e kishte planifikuar qëllimisht fjalimin e tij për në orën 18:30, në mënyrë që të priste reagimet e liderëve politikë nga rajoni, konkretisht nga Shqipëria e Kosovë. Ai i cilësoi si të papranueshme reagimet e liderëve të Shqipërisë, Kosovës, por edhe të rajonit.

[Artikulli i medias serbe:](#)

"Po prisja të shihja deklaratat e të gjithëve dhe që ju të shihnit se me çfarë problemesh po përballlet Serbia sot dhe sa shumë hipokrizi po përballemi", tha Vuçiç.

Fillimisht, ai lexoi reagimin e Presidentit të Shqipërisë, Bajram Begaj, i cili shprehu "trishtim të thellë" për vendimin e gjykatës dhe deklaroi se "për shqiptarët, askush dhe asgjë nuk mund ta njollojë UÇK-në" dhe se "liria ka një emër".

Deklarata e Begajt u publikua pas shpalljes së aktgjykimit.

"Vetëm imagjinoni sikur një prej zyrtarëve tanë të thoshte: 'Liria ka një emër' dhe të përmendte cilindo serb të dënuar nga Tribunali i Hagës", tha Vuçiç.

Ai përmendi gjithashtu reagimin e Kryeministrit shqiptar Edi Rama, i cili pas shpalljes së aktgjykimit publikoi në rrjetet sociale fjalën "turp".

Duke folur për reagimet nga Prishtina, Vuçiç citoi Albin Kurtin, i cili e cilësoi aktgjykimin si "një padrejtësi të papranueshme" dhe "një dënim të rëndë", duke thënë se ai duhet të ndryshohet në procesin e apelimit.

Presidenti serb veçoi më pas një deklaratë të Zëvendëskryeministrit të Malit të Zi, Niko Đeljošaj, i cili e cilësoi aktgjykimin "jashtëzakonisht të padrejtë" dhe tha se "çdo shqiptar e mban në zemër luftën e shenjtë të UÇK-së". Đeljošaj deklaroi gjithashtu se beson se vendimi do të ndryshohet përpara instancave më të

larta gjyqesore.

Vuçiç pyeti nëse deklarata të tilla do të kenë pasoja për integrimin evropian të Malit të Zi.

“A do ta ndalojnë integrimin evropian sepse përshtyjnë mbi aktgjykimin, mohojnë sundimin e ligjit? Apo kjo vlen vetëm për serbët?”, pyeti Presidenti.

Ai iu referua gjithashtu reagimeve të politikanëve shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, përfshirë Bekim Salin, Kryetarin e Kuvendit Afrim Gashin dhe liderin e BDI-së, Ali Ahmeti.

Ahmeti e cilësoi aktgjykimin si të padrejtë dhe thellësisht zhgënjyes.

“Dhe unë mendoja se ata ishin kriminelë, të paktën të dënuar në shkallë të parë. Jo, ata janë të gjithë çlirimtarë, heronj dhe heroinat”, tha Vuçiç.

Ai iu referua gjithashtu qëndrimit të diplomacisë kroate, duke deklaruar se Zagrebi, ndërsa shprehu se “e merr në dijeni” aktgjykimin, në të njëjtën kohë theksoi qëndrimin e tij lidhur me kontekstin politik dhe historik të luftës në Kosovë.

Vuçiç vlerësoi se këto reagime tregojnë edhe një herë se viktimat serbe po shtypen nga narrativa publike dhe politike.

“Serbët duhet të jenë kriminelë në çdo komunikatë, në çdo deklaratë”, tha Presidenti.

“Nëse nuk i kujtojmë viktimat tona, askush nuk do t’i kujtojë”

Vuçiç tha se reagimet që pasuan aktgjykimin përfaqësojnë, sipas tij, një mësim të rëndësishëm për Serbinë sa i përket kulturës së kujtesës.

“Ashtu siç kemi zhvilluar një kulturë përkujtimi, duke respektuar gjithmonë viktimat e të tjerëve, por duke zhvilluar gjithashtu një kulturë përkujtimi për viktimat tona, edhe në këtë çështje do të duhet të bëjmë ende shumë.

Sepse, nëse nuk i kujtojmë viktimat tona, askush nuk do t’i kujtojë kurrë. Askush nuk do t’i përmendë madje”, tha presidenti.

Ai vlerësoi se reagimet nga rajoni tregojnë ekzistencën e standardeve të ndryshme ndaj serbëve dhe popujve të tjerë të ish-Jugosllavisë.

“Mund të kesh aktgjykime të formës së prerë dhe jo të formës së prerë, nuk ka rëndësi. Serbët do të jenë gjithmonë kriminelë, ndërsa të gjithë të tjerët do të jenë çlirimtarë, heronj dhe heroinat”, tha Vuçiç

“Dialogu është gjithmonë më i mirë se konflikti”

Presidenti e përfundoi fjalimin e tij me mesazhin se, pavarësisht gjithçkaje që kishte thënë, politika e Serbisë duhet të mbetet e përqendruar në ruajtjen e paqes dhe vazhdimin e dialogut.

Ai vlerësoi se ishte gabim që, sipas tij, komuniteti ndërkombëtar lejoi ndërprerjen e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe përpjekjet për zgjidhjen e çështjeve në Kosovë përmes veprimeve të njëanshme dhe të dhunshme.

“Ne besojmë se dialogu është gjithmonë një zgjidhje më e mirë se çdo konflikt dhe duam që dialogu të vazhdojë”, tha Vuçiç.

Serbia, shtoi ai, do të vazhdojë të dialogojë me të gjitha vendet dhe popujt e rajonit, pavarësisht dallimeve dhe fjalëve të ashpra.

“Këta janë njerëz me të cilët jetojmë, disa së bashku, disa si fqinj. Do të duhet të përpiqemi t’i përmirësojmë këto marrëdhënie, por jo në një mënyrë që ne vetëm t’u shërbejmë atyre ose që ata të mendojnë se mund ta poshtërojnë dhe në fund ta mposhtin Serbinë”, tha Vuçiç.

Sipas tij, marrëdhëniet në rajon mund të përmirësohen vetëm përmes dialogut të civilizuar dhe respektimit të interesave legjitime të të gjitha palëve.

“Çdo bisedë dhe çdo dialog është shërues dhe besoj se është gjithmonë më mirë se çdo gjë tjetër”, përfundoi Presidenti i Serbisë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

Vuçiç tërbohet me Nik Gjeloshajn që tha se “çdo shqiptar mban në zemër luftën e shenjtë të UÇK-së”: A do të ndalet integrimi i Malit të Zi në BE??

20:52 Rajoni

Shtohen zërat për shpërbërjen e Speciales, Këshilli Shqiptaro-Amerikan dënon vendimin për 4 ish-krerët e UÇK

20:50 Rajoni

“Asnjë gjyqtar nga Haga nuk i përket Kosovës”- Dënimi i ish-liderëve të UÇK, reagon Meidani: Konteksti historik s’d

20:20 Rajoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.